

VENDIM
Nr.506, datë 30.6.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin e parë të pikës 2, fjalët “...Lidhjes II/1, “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë”,...” shfuqizohen.

2. Lidhja II “Paga bazë sipas klasave” dhe lidhja II/1 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e shëndetësisë”, zëvendësohen me lidhjen II “Paga bazë sipas klasave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Lidhja II/M “Paga bazë për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, ATSH-së, prefekturave dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtën emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Shtohet lidhja II-17 “Niveli i pagave për punonjësit jomësiorë të universiteteve dhe të shkollave të tjera të larta, dhe për punonjësit civilë jomësiorë të Universitetit Ushtarak dhe të Akademisë së Mbrojtjes”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Shtohet lidhja II-33 “Niveli i pagave për punonjësit e Bibliotekës Kombëtare”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Efektet financiare për pagat e sigurimet shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i pashpërndarë i pagave, në bazë të përcaktimit të bërë në nenin 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të viti 2005”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA II

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	11 800
2	II	12 100
3	III	12 300
4	IV	12 600
5	V	12 900
6	VI	13 200
7	VII	13 600
8	VIII	14 000
9	IX	14 500
10	X	15 000
11	XI	16 000
12	XII	17 000
13	XIII	19 000
14	XIV	23 000

LIDHJA II/M

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE,
INSTITUCIONEVE TË TJERA QENDRORE, ATSH-SË, PREFEKTURAVE
DHE SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	11 800
2	II	12 100
3	III	12 500
4	IV	13 000
5	V	14 000
6	VI	15 000
7	VII	17 000
8	VIII	19 000
9	IX	21 000
10	X	25 500

LIDHJA II/17

NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT JOMËSIMORË TË UNIVERSITETEVE DHE
SHKOLLAVE TË TJERA TË LARTA, DHE PËR PUNONJËSIT CIVILË JOMËSIMORË TË
UNIVERSITETIT USHTARAK DHE AKADEMISË SË MBROJTJES

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi	
1.	Kancelar në universitet	B3	
2.	Drejtor i bibliotekës shkencore të universiteteve	B4	
2.	Kancelar në fakultetet ¹	B4	
3.	Kancelar në fakultetet ²	B5	
4.	Kryetar dege në rektorat	B5	
Nr.	Emërtimi	Klasa e pagës	Shtesa për funksion
1.	Kryetar dege në fakultet Përgjegjës biblioteke Përgjegjës sektori në rektorat Përgjegjës sektori në bibliotekën shkencore të universitetit	IX	5
2.	Kryesekretar	IX	2
3.	Klasifikator Sekretar i rektorit Bibliograf Kryebibliotekar	IX	
4.	Specialist Bibliotekar në bibliotekën shkencore të universitetit Laborant me arsim të lartë	VIII	
5.	Bibliotekar në bibliotekat e fakultetit dhe Akademisë së Mbrojtjes Sekretare mësimore	VII	
6.	Laborant me arsim të mesëm Restaurator	VI	
7.	Shoferi i rektorit Preparator Ekonomist i mesëm Kolektor Punonjës blegtorie	V	

Shënim. Për punonjësit e tjerë zbatohet lidhja II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore”.

LIDHJA II-33

NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi	
-----	----------	-------------	--

¹ Kancelar në fakultetet që kanë fituar autonominë financiare.

² Kancelar në fakultetet që nuk kanë fituar autonominë financiare.

1.	Drejtor i bibliotekës	B3	
2.	Zëvendësdrejtor	B5	
Nr.	Emërtimi	Klasa e pagës	Shtesa për funksion
1.	Përgjegjës sektori në bibliotekë	IX	5
2.	Klasifikator Bibliograf	IX	
4.	Specialist. Bibliotekar. Kryellogaritar	VIII	
5.	Ndihmësbibliotekar	VII	
6.	Restaurator	VI	

Shënim. Për punonjësit e tjerë zbatohet lidhja II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”.